REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr. br. 848/20
Data/Datum 03.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr. 848/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068,dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenkovic - Kryetar Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "Hekurani" SH.P.K. - Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizime me nyje lidhëse për SRs-470 dhe BRs-1200" me nr. të prok: KEKO-20-431-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., më datë: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Hekurani" SH.P.K. - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizime me nyje lidhëse për SRs-470 dhe BRs-1200" me nr. të prok: KEKO-20-431-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.

II. **VËRTETOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizime me nyje lidhëse për SRs-470 dhe BRs-1200" me nr. të prok: KEKO-20-431-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Hekurani" SH.P.K. - Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.10.2020 me nr. 848/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizime me nyje lidhëse për SRs-470 dhe BRs-1200" me nr. të prok: KEKO-20-431-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59, 60 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti teknik i prokurimit në raportin e dt: 28.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket pretendimit 1, eksperti shqyrtues/teknik sqaron se në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, përkatësisht pas përgjigjes kundrejtë kërkesës së AK për sqarim, i njëjti ka dorëzuar katalog/ pjesë të katalogut sipas specifikimeve teknike të kërkuara sipas Ankesi 1 të DT. Prandaj këtë pretendim ankimorë e kualifikojmë si të pabazuar.

Sa i përket pretendimit 2, eksperti shqyrtues/teknik sqaron se duke u bazuar në LPP dhe RRUOPP, është dorëzuar specifikacioni teknik për mallrat e ofruara, por mungon katalogu. Mund te kërkohen informata sqaruese sipas nenit 69 RRUOPP. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit 3, eksperti shqyrtues/ teknik sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij të ofruar, ka ofruar vetitë mekanike të metalve (Rm,Re,Kv,A,F), nga instituti i metarlugjisë.

Mehanička karakterizacija materijala GS-E28Mn6V koji će Institut koristiti za izradu premetnih odlivaka za pozicije 1 i 2 biće urašena u skladu sa dostavljenom tehničkom dokumentacijom :

Poz	*Opis*	*Materijal*	*Crtež br.*	*Mehaničke karakteristike*
1	Spojni zglobovi SRs-470	GS-E28Mn6V	R3-7.01.06489.00	HRC - 40±2
2	Spojni zglobovi BRs-1200	GS-E28Mn6V	596.001-0801:1	HRC - 40±2

Institut je spreman da izađe u susret u pogledu laboratorijskih ispitivanja i u slučaju posebnih zahtjeva od Naručioca, saglasno dokumentaciji o kompetentnosti Akreditovane Laboratorije, koju prilažemo.

INSTITUT ZA CRNU METALURGIJU AD NIKŠIĆ

Izvršni direktor
Ranko Nikolić

Andaj, pretendimi ankimorë i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit 4, eksperti shqyrtues/teknik sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar diagramet e përpunimit termik për materialet e kërkuar sipas ankesi 1 të DT. Po ashtu operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar deklaratë ku potencohet se: Me këtë deklarojmë se Instituti i Metalurgjisë AD - Niksic, Mali i Zi, është kompetent për prodhimin dhe dorëzimin e pjesëve të porositura në rast të dhënies së Kontratës për KEK - 20 - 431 - 1 - 2 - 1: Prokurimi i bashkimeve për ekskavatorët SRs 470 dhe BRS 1200 Laboratori për Testim Destruktiv i Institutit të Metalurgjisë së Ferrë AD Nikçiq, pajisjet e dorëzuara për pozicionet 1 dhe 2, mund të kryejë një provë të karakteristikave mekanike: testi i elasticitetit / rezistencës së ndikimit i kryer në temperaturën e dhomës + 20 'C. Për të gjitha testet kemi laboratorë të akredituar (CERTIFIKATA E AKREDITIMIT sipas MASHT EN ISO / IEC 17025: 2011) me staf të trajnuar.

Nyje për SRs 470 Nyje per BRs 1200.





Andaj pretendimi ankimorë i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së njoftimi për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Hekurani" SH.P.K. – Ferizaj, kundrejt ofertës së OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, përkatësisht pas përgjigjes kundrejt kërkesës së AK për sqarim, i njëjti ka dorëzuar katalog/ pjesë të katalogut sipas specifikimeve teknike të kërkuara sipas Ankesi 1 të DT. Andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "Hekurani" SH.P.K. – Ferizaj. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se duke u bazuar në LPP dhe RRUOPP, është dorëzuar specifikacioni teknik për mallrat e ofruara, por mungon katalogu. Mund te kërkohen informata sqaruese sipas nenit 69 RRUOPP. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Hekurani" SH.P.K. – Ferizaj, kundrejt ofertës së OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij të ofruar, ka ofruar vetitë mekanike të metalve (Rm,Re,Kv,A,F), nga instituti i metarlugjisë.

Mehanička karakterizacija materijala GS-E28Mn6V koji će Institut koristiti za izradu premetnih odlivaka za pozicije 1 i 2 biće urašena u skladu sa dostavljenom tehničkom dokumentacijom :

Poz	*Opis*	*Materijal*	*Crtež br.*	*Mehaničke karakteristike*
1	Spojni zglobovi SRs-470	GS-E28Mn6V	R3-7.01.06489.00	HRC - 40±2
2	Spojni zglobovi BRs-1200	GS-E28Mn6V	596.001-0801:1	HRC - 40±2

Institut je spreman da izađe u susret u pogledu laboratorijskih ispitivanja i u slučaju posebnih zahtjeva od Naručioca, saglasno dokumentaciji o kompetentnosti Akreditovane Laboratorije, koju prilažemo.

INSTITUT ZA CRNU METALURGIJU A.D. NIKŠIĆ

Izvršni direktor
Ranko Nikolić

Andaj, pretendimi ankimorë i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Hekurani" SH.P.K. – Ferizaj, kundrejt ofertës së OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar diagramet e përpunimit termik për materialet e kërkuar sipas ankesi 1 të DT. Po ashtu operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar deklaratë ku potencohet se: Me këtë deklarojmë se Instituti i Metalurgjisë AD - Niksic, Mali i Zi, është kompetent për prodhimin dhe dorëzimin e pjesëve të porositura në rast të dhënies

së Kontratës për KEK - 20 - 431 - 1 - 2 - 1: Prokurimi i bashkimeve për ekskavatorët SRs 470 dhe BRS 1200 Laboratori për Testim Destruktiv i Institutit të Metalurgjisë së Ferrë AD Nikçiq, pajisjet e dorëzuara për pozicionet 1 dhe 2, mund të kryejë një provë të karakteristikave mekanike: testi i elasticitetit / rezistencës së ndikimit i kryer në temperaturën e dhomës + 20 'C. Për të gjitha testet kemi laboratorë të akredituar (CERTIFIKATA E AKREDITIMIT sipas MASHT EN ISO / IEC 17025: 2011) me staf të trajnuar.

Nyje për SRs 470


INSTITUT ZA CRNU METALURGIJU AD - NIKŠIĆ

PREDMET: Termička obrada za:
Spojni zglobovi - Tip br.1 - SRs 470

Normalizacija:

Kaljenje:

Nyje per BRs 1200.


INSTITUT ZA CRNU METALURGIJU AD - NIKŠIĆ

PREDMET: Termička obrada za:
Spojni zglobovi - Tip br.2 - BRs 1200

Normalizacija:

Kaljenje:

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë konform nenit 59 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase,

më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KEK sh.a.;

1x1 OE "Hekurani" SH.P.K. – Ferizaj;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.